



VENDIM

Nr 91 datë 28.07.2015

PËR

LICENSIMIN E SHOQËRISË “ENERGAL” SH.P.K., NË AKTIVITETIN E TREGËTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16 , 37 germa d, dhe 110 te ligjit 43/2015 “Për sektorin e energjisë ekektike”, nenit 4 pika 1 germa “g”, neni 5 pika 2 dhe neneve 13 dhe 14 të “Rregullores për Proçedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjessbëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, Bordi i E.R.E, në mbledhjen e tij të datës 28.07.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “ENERGAL” sh.p.k. si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

1. Shoqëria “ENERGAL” sh.p.k ka aplikuar për tu pajisur me licensë për aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike në datën 30.04.2015 në zbatim të *Ligjit nr. 9072, datë 23.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”,* të ndryshuar. Bordi i Komisionerëve të ERE-s me vendimin nr. 63, datë 11.05.2015, miratoi fillimin e procedurave për liçensimin ne aktivitetin e tregëtimit të shoqërisë “ENERGAL” sh.p.k.
2. Njoftimi i kërkesës për licencim të këtij subjekti është kryer ne zbatim të nenit 16 të ligjit Nr 9072 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” të ndryshuar.
3. Në datën 15.05.2015 ka hyrë në fuqi Ligji nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.
4. Në Ligjin nr 43/2015, neni 110 pika 1, është parashikuar që Ligji nr 9072 datë 22.05.2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” të ndryshuar si dhe çdo dispozitë tjetër ligjore që bie në kundërshtim me ligjin nr 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, shfuqizohet.
5. Në Ligjin nr 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” në zbatim të detyrimeve që burojnë nga vete ligji në nenin 39 dhe nenin 108 pika 3 të tij, në nenin 110

pika 2 të tij parashikohet se : *Aktet nënligjore, që rregullojnë veprimtaritë në sektorin e energjisë elektrike, të miratuara përpara hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të zbatohen për aq sa nuk bien në kundërshtim me këtë ligj, deri në rishikimin e tyre dhe daljen e akteve të reja, në përputhje me kërkesat dhe afatet e vendosura në këtë ligj.*

Për sa me sipër si dhe duke qene se aplikimi i shoqërisë “ENERGAL” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të plotë/të pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Të dhënat specifike sipas tipit të licensës (neni 9, pika 4./10 gërmat “a”, “b” dhe “c”) janë plotësuar në mënyrë korrekte.

Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Licensimin e shoqërisë “**ENERGAL**” sh.p.k, ne aktivitetin e tregëtimit të Energjisë Elektrike për një afat 26 vjeçar.
2. Drejtoria e Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Kryetari i ERE

Petrit Ahmeti

Në mungesë dhe me porosi

Adriatik BEGO